VENDIM
Nr. 54, datë 29.4.2016

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "AE DISTRIBUTION" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa "d" dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", neneve 4, pika 1, germa "g"; 5, pika 1, germa "g"; 10, pika 3, të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa "a" e "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.4.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "AE Distribution" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "AE Distribution" sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b" dhe "c") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d", "e", "f", "g") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Të dhënat specifike të licencës (neni 9, pika 4/10, germat "a", "b" dhe "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë "AE Distribution" sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti